

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LEZHË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Lezhë me objekt: “Mbi vlerësimin aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitjeve të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve prone publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm etj,” dhe dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr 5, datw 24.01.2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 266/8, datë 24.01.2012, dërguar **z. Viktor TUSHAJ**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Në kontratat e sipërmarrjeve të ndërtimit, për objektet që kanë afat përdorimi të gjatë, afati i garancisë të vendoset në përputhje me nenin 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, jo më pa se 10 vjet.

**Vazhdimisht**

**2.** Marrja në dorëzim e punimeve të pastrimit, të dokumentohet me procesverbal të matjes së volumeve, vërtetimit nga kryetarët e lagjeve, për sasinë dhe cilësinë e punimeve, si dhe situacionin e punimeve të certifikuar nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Financës, duke ndryshuar menjëherë procedurat e paligjshme të deritanishme.

**Menjëherë**

**3.** Të pezullohet dhënia e lejeve të shesheve dhe të ndërtimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Lezhë, nga KRRTRSH-ja.

**Menjëherë**

**4.** Të pezullohen punimet e ndërtimit në objektin “Ndërtim lokal 1 kat, banese 2 kat + bodrum” që kryhen nga z. ■■■ në objektin “Godinë shërbimesh 2-3 kat dhe 2 kat bodrum”, që kryhen nga z. ■■■, dhe të fillojë zbatimi i masave ligjore të parashikuara për ndërtimet pa leje, konform ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, me ndryshime.

**Menjëherë**

5. Të merren masa për arkëtimin e vlerës së qirave të pa shlyera në shumën 1.547.168 lekë, që ju përket 7 qiramarrësve të parregullt në zbatimin e kontratave të periudhës 01.07.2009 deri 30.06.2011, sipas listës së debitorë që është evidentuar nga Drejtoria e Financës, ose të prishen kontratat në rrugë ligjore.

**Menjëherë**

6. Nga Kryetari i Bashkisë, të ngrihen grupet e punës, për verifikimin e pasurive të paluajtshme, që i kanë kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave përfundimisht në përgjegjësi juridike bashkisë dhe që përdoren nga të tretët (troje dhe ndërtesa), duke i kaluar ato menjëherë në pronësi juridike të Bashkisë dhe në aktivet e saj.

**Menjëherë**

7. Nga Klubi Sportiv të programohen të ardhura nga shitja e biletave të sportit për çdo vit buxhetorë dhe të mos zhvillohen ndeshje në stadium pa bileta.

**Menjëherë**

8. Të lëshohen menjëherë autorizimet për pagesën e detyrimeve për lejet e ndërtimit sipas vendimeve të KRRT-së, për;

a. ████████ VKRRTB nr .50, datë 03.12.2010, me objekt 1 “Ndërtim godinë banimi dhe shërbimesh 1 deri 10 kat + 1 kat parkim nëntokë”, për vlerën 65.279.414 lekë

b. ████████ VKRRTB nr. 51, datë 26.02.2011 me objekt “ Ndërtim godinë banimi dhe shërbimesh 10 + 1 kat, garazh nëntokë”, për vlerën . 14.076.299 lekë dhe në rast se të interesuarit e mësipërm nuk likuidojnë menjëherë detyrimet, tu anulohen lejet e ndërtimit.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit shkaktuar buxhetit të Bashkisë, në vlerën **13.844.749.10 lekë** si më poshtë:

1. Vlera **14.930 lekë**, për dieta të paguara tepër, përkatësisht: ██████. 10.140 lekë, ██████ 1.950 lekë, ██████ 2.480 lekë dhe ██████. 360 lekë.

**Menjëherë**

2. Vlera prej **1.602.000 lekë**, nga Subjekti ██████ përfituar në kundërshtim me ligjin gjatë zbatimit të kontratës datë 22.6.2009, me objekt “Asfaltim i Rrugës Kodër Marlekaj”.

**Menjëherë**

3. Vlera prej **303.634 lekë**, nga z. ██████, për dëmin e shkaktuar nga llogaritja e vlerës së kontratës me objekt “Rikonstruksion i Rrugëve Kryesore të Qytetit, Blloku pas Poliklinikës”.

**Menjëherë**

4. Vlera prej **3.261.658 lekë**, nga [REDACTED] penalitete sipas kontratës datë 25.02.2011, me objekt “Sistemim, asfaltim, ndriçim, blloku 11.2 ha”, për mos zbatim në afat të punimeve.

**Menjëherë**

5. Vlera prej **168.264 lekë**, nga [REDACTED] paguar më tepër, për volume të pa kryera, gjatë zbatimit të kontratës datë 01.07.2011, me objekt “Shërbimi i gjelbërimit në qytetin e Lezhës”.

**Menjëherë**

6. Vlera prej **2.557.443.10 lekë**, për llogaritje më pak të detyrimeve, si pasojë mos pagesës të tyre, lidhur me lejet e ndërtimit, nga përfituesit e mëposhtëm:

- [REDACTED] 1.826.702 lekë, (leje nr. 48, dt.26.11.09 dhe 52, dt.07.4.11)
- [REDACTED] 223.285 lekë, (leje nr. 48, datë 26.11.09)
- [REDACTED] 1.238 lekë, (leje nr. 49, datë 22.6.2010)
- [REDACTED] 201.596 lekë, (leje nr. 49, datë 22.6.2010)
- [REDACTED] 500.000 lekë, (leje nr. 50, datë 03.12.2010)
- [REDACTED] 6.208.10 lekë, (leje nr. 51, datë 26.02.2011)

**Menjëherë**

7. Vlera prej **5.936.820 lekë**, nga [REDACTED] për përfitime të paligjshme në pagat dhe shpërblimet, sipas listës nr. 1 bashkëlidhur.

**Menjëherë**

**C. MASA ADMINISTRATIVE**

Ti rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 të ndryshuar dhe Kreu X të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, të japë masa administrative për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike zhvilluar në periudhën 2009-2011, personave si më poshtë:

1. znj. [REDACTED] Juriste e Njesisë së Prokurimit
2. znj. [REDACTED] Juriste e Njesisë së Prokurimit
3. z. [REDACTED] Specialist i Njesisë së Prokurimit
4. z. [REDACTED] Specialist i Njesisë së Prokurimit
5. zj. [REDACTED] Specialiste e Njesisë së Prokurimit

**Shkeljet konsistojnë:**

**a.** Në llogaritjen e kufirit monetar. Njësia e Prokurimit (NP), ka marrë për bazë vlerën e preventivit të hartuar projektuesit, çmimet e të cilit nuk janë bazuar në analizat teknike të çmimeve të miratuara nga organet shtetërore, gjë që bie në kundërshtim me kreu II, pika 2, shkronja "c" të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për prokurimin publik" dhe pika 2 e VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", ku përcaktohet qartë se për llogaritja e vlerës limit, bëhet në bazë çmimeve zyrtare të publikuara, çmimet e tregut, apo përvoja e mëparshme, gjë që ka shkaktuar edhe dëm ekonomik për buxhetin e Shtetit apo të Bashkisë.

**b.** Në hartimin e dokumenteve të tenderit. NP, në rastin e dokumentacionit teknik, nuk ka administruar në dosje, dokumente që vërtetojnë se projekti e preventivi, të hartuar nga projektuesit, janë zyrtar, pasi nuk rezultojnë këto dokumente:

- procedura e prokurimit për përzgjedhjen e projektuesit, dhe kontrata e porosisë,
- detyra e projektimit,
- projektideja dhe preventivi paraprak,
- akti i marrjes në dorëzim të projektit, miratimi nga Kryetari dhe Sekretari i KRRT.

Në hartimin e dokumenteve të tjerë, të cilët janë nën përgjegjësinë direkt të NP për tu hartuar, në disa raste nuk janë caktuar kriteret e veçanta për kualifikim.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, nenet 41 dhe 46, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 2/a, dhe ngarkojnë me përgjegjësi NP.

**c.** Në lidhjen e kontratave, pasi nuk është parashikuar afati i garancisë së punimeve sipas nenit 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me ndryshime, ku afati i garancisë për objektet që kanë destinacion përdorimi afat gjatë, është 10 vjet, gjë që ngarkon me përgjegjësi juristet e NP që kanë konceptuar kontratat, etj.

### **Ç. MASA DISIPLINORE**

**C/1-** Mbështetur në nenin 25, pika 3/a, 3/b, 3/ç dhe 3/d të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", pikën 1, të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", pika 1, nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe kontratës individuale të Punës, Kryetari i Bashkisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

**“Largim nga shërbimi civil”, për:**

**z. ■■■**, me detyrë K/Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor në Bashkinë Lezhë, pasi gjatë ushtrimit të detyrës:

- nuk ka ushtruar kontrole në mbi 70 objektet, për të cilët janë dhënë lejet e ndërtimit nga KRRT-ja për përudhen 01.07.2009 - 30.06.2011,

- nuk ka ushtruar kompetencat që i jep ligji nr. 9870, datë 16.07.2007, neni 5, për pezullimin dhe prishjen e dy ndërtimeve pa leje të Bashkisë në anën veriore të urës mbi lumin Drin të Qytetit të Lezhës,

- për shkeljet e konstatuara nuk ka bërë asnjë propozim për heqje licence apo për kallëzim penal gjatë periudhës së kontrolluar,

- nuk ka arkëtuar asnjë lekë, nga gjobat prej 170.000 lekë, të vendosura në 7 raste për kundërvajtje.

**C/2-Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe Kontratën Individuale të Punës, Kryetari i Bashkisë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:**

**“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:**

**1. z. ■■■** me detyrë Përgjegjës i Klubit Sportiv “Besëlidhja”,

**2. z. ■■■** me detyrë Specialist Finance, në Klubin Sportiv “Besëlidhja”, pasi gjatë ushtrimit të detyrës, kanë bërë trajtimin e sportistëve me paga e shpërblime të nivelit të lartë, në kundërshtim me ligjin nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, duke shkaktuar një dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë prej **5.936.820 lekë**.

**Për z. ■■■**, ish-Drejtor i Urbanistikës së Bashkisë të mjaftohet me largimin nga detyra me vendim të Kryetarit të Bashkisë, por për këtë të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, pasi, gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer shkelje të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Mbi miratimin e rregullores së urbanistikës”, në pranimin e 70 kërkesave për leje ndërtimi pa dokumentacionin e duhur ligjor, në llogaritjen e gabuar të detyrimeve për lejet e ndërtimit duke shkaktuar një dem ekonomik prej **2.557.443.10 lekë, etj.**

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pal Gjoni, Kujtim Rama dhe Pal Daçi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Osman Alushi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**